



Direktiva 2005/56/KE **Pasqyruar në Praktikë**

**Publikuar përmes Raportit të ‘SME’
‘Informacion dhe Konsultë, Sfidat Inovatore’**

Përgjegjësia e këtij produkti i përket vetëm autorit dhe Komisioni nuk mban përgjegjësi për asnjë lloj ndryshimi të mundshëm të kryer në këtë produkt.



Ky projekt është bashkefinancuar
nga Bashkimi Europian

Pasqyra e Lëndës

Hyrje.....	3
Direktiva 2005/56/ KE – Një shikim i detajuar	4
Pjesmarrja e Punonjësve/ Të drejtat në pjesmarrjen e punonjësve.	11
Direktiva 2005/56/ KE dhe e Drejta e Pjesmarrjes së Punonjësve....	12

HYRJE

Ashtu siç pasqyrohet qartësisht edhe nga hyrja, kjo Direktivë lind me synimin e lehtësimit të bashkimeve ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar që dëshirojnë të ruajnë potencialin e tregut të vetëm.

Ashtu siç referohet nga Direktiva, analizimi i së cilës fillon tani, ajo ka si objektiv lehtësimin dhe promovimin e bashkimeve ndërkufitare mes shoqërive me përgjegjësi të kufizuar të pjesëtarëve të ndryshëm të Shteteve Anëtare, duke lehtësuar procedurat.

Për të lehtësuar operimin e bashkimeve ndërkufitare, është e rëndësishme të sqarohet paraprakisht, vetëm në rast se Direktiva e parashikon ndryshe, që çdo shoqëri që merr pjesë në një bashkim ndërkufitar, si dhe palë të treta të interesuara, mbeten subjekte të dispozitave dhe formaliteteve të ligjit kombëtar që do të zbatohet në rast të një bashkimi kombëtar.

Asnjë prej dispozitave apo formaliteteve të ligjit kombëtar, të përmendura në këtë Direktivë, nuk duhet të vendosi kufizime mbi lirinë e krijimit apo mbi lirinë e lëvizjes së lirë të kapitalit, vetëm në rast se kjo mund të justifikohet në përputhje me precedentët ligjorë të Gjykatës së Drejtësisë dhe në veçanti, nga kërkesat me interes të përgjithshëm, si dhe kur janë të dyja të nevojshme dhe në proporcion me arritjen e kërkesave të tilla thelbësore.

Për zhvillimin e këtij qëllimi do të duhet të bazohemi në një projekt të përbashkët bashkimi, me të njëjtat kushte për secilën prej shoqërive të përfshira në këtë projekt, pra, duke zotëruar një përmbajtje minimale të këtij projekti. Gjatë këtij procesi, kushtet paraprake të përbashkëta për bashkimet ndërkufitare dhe përfundimi i bashkimit ndërkufitar duhet të publikohen për çdo shoqëri që bashkohet nëpërmjet hyrjes në regjistrin e duhur publik, por përpara se të përpilohet një raport mbi projektin e bashkimit. Draft kushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar do të vendosen me takime të përgjithshme të secilës shoqëri.

Për të lehtësuar operacionet e bashkimeve ndërkufitare, duhet siguruar që monitorimi i kryerjes dhe ligjshmërisë së procesit vendimmarrës në çdo shoqëri të bashkuar të kryhet nga autoriteti kombëtar që ka juridiksion mbi secilën nga këto shoqëri, ndërsa monitorimi i kryerjes dhe ligjshmërisë së bashkimit ndërkufitar duhet të bëhet nga autoriteti kombëtar që ka juridiksion mbi shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar. Autoriteti kombëtar në fjalë mund të jetë një gjykatë, një noter ose çdo autoritet tjetër kompetent i caktuar nga Shteti Anëtar i interesuar. Duhet specifikuar gjithashtu ligji kombëtar që përcakton datën në të cilën bashkimi ndërkufitar hyn në fuqi, duke qenë se ky është ligji subjekt i së cilës është shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

Me qëllim që të mbrohen interesat e anëtarëve dhe palëve të tjera, duhen specifikuar efektet ligjore të bashkimit ndërkufitar, duke bërë dallimin nëse shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar është një shoqëri blerëse apo një shoqëri e re. Në interes të sigurisë ligjore, nuk duhet të jetë më e mundur që bashkimi të deklarohet ligjërisht i pavlefshëm pas datës kur bashkimi ndërkufitar hyn në fuqi.

Të drejtat e punonjësve, përveç të drejtave të pjesëmarrjes, duhet të mbeten subjekte të dispozitave kombëtare të referuara në Direktivën e Këshillit 98/59/KE të datës 20 korrik 1998, lidhur me shkurtimet kolektive, në Direktivën e Këshillit 2001/23/KE të datës 12 mars 2001, mbi mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në punë në rast transferimi të shoqërive, ndërmarrjeve apo pjesëve të ndërmarrjeve dhe bizneseve, në Direktivën 2002/14/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 mars 2002 që krijon një kuadër të përgjithshëm për informimin dhe këshillimin e punonjësve në Komunitetin Evropian, në Direktivën e Këshillit 94/45/KE të datës 22 shtator 1994 mbi themelimin e Këshillit Evropian të Punës apo një procedure për ndërmarrje në shkallë komuniteti dhe grupe ndërmarrjesh në shkallë komuniteti me qëllim informimin dhe këshillimin e punonjësve, si dhe Direktivën 2009/38/KE - e ashtuquajtura “Direktiva e Ndryshuar” që rishikon Direktivën 94/45/EC.

Direktiva 2005/56/KE – një vështrim më i detajuar

▪ *Aplikimi*

Kjo Direktivë do të zbatohet për bashkimet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar të krijuara në përputhje me ligjin e një Shteti Anëtar, me kusht që të paktën dy nga ato shoqëri të rregullohen nga ligjet e Shteteve Anëtare të ndryshme dhe të kenë zyrën e tyre të regjistruar, administratën qendrore apo vendin kryesor të biznesit brenda Komunitetit, më poshtë të referuar si:
të përcaktuar për:

“Bashkime Ndërkufitare”

Kështu kemi si faktorët fillestarë apo si kërkesa vendimtare për zbatimin e kësaj Direktive:

Një element objektiv:

Shoqëritë që bashkohen duhet të krijohen si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Shtetin Anëtar ku shoqëria është e vendosur; dhe

Ato duhet të kenë zyrën e tyre të regjistruar, administratën qendrore apo ndërmarrjen brenda territorit të BE-së;

Dhe

Të përfshijnë, të paktën, dy prej këtyre shoqërive apo shoqërive të qeverisura nga ligjet të Shteteve Anëtare të ndryshme.

Një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duhet kuptuar sipas legjislacioneve të ndryshme të Shteteve Anëtare dhe sipas asaj që referohet në nenin 1 të Direktivës 68/151 /CEE¹:

Një shoqëri me kapital aksionar;

Me personalitet juridik;

Që zotëron pasuri të veçanta të cilat shërbejnë vetëm për të mbuluar borxhet e saj;

T'i nënshtrohet ligjit kombëtar që e qeveris sipas kushteve që lidhen me garancitë, si ato që parashikohen nga Direktiva 68/151/KEE, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të tjera.

Çfarë kuptohet me **bashkim**?

Përfshirja

“Një ose më shumë shoqëri që shpërbëhen pa shkuar në likuidim, ia transferojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e tyre një shoqërie tjetër ekzistuese, shoqërisë blerëse, në këmbim të lëshimit për pjesëtarët e saj të letrave me vlerë dhe aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë tjetër dhe, nëse është e zbatueshme, një pagese me para në dorë që nuk i tejkalon 10% të vlerës nominale apo, në mungesë të vlerës nominale, të llogarive në vlerë nominale të atyre letrave me vlerë apo aksioneve.”

Një bashkim përmes përfshirjes do të thotë që një shoqëri ekzistuese do të “përfshijë” një ose më shumë shoqëri që tashmë ekzistojnë. Këto të fundit nuk do të ekzistojnë më dhe do të mbetet vetëm një shoqëri, shoqëria blerëse.

Themelimi i një shoqërie të re

«Dy apo më shumë shoqëri që shpërbëhen pa shkuar në likuiditet, i transferojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e tyre në një shoqëri që krijojnë, shoqëria e re, në këmbim të lëshimit anëtarëve të tyre të letrave me vlerë apo aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e kësaj shoqërie të re dhe, nëse është e zbatueshme, një pagese me para në dorë që nuk e kalon 10% të vlerës nominale, ose në mungesë të vlerës nominale, të llogarive në vlerë nominale të atyre letrave me vlerë apo aksioneve”.

Në këtë rast krijohet një entitet i ri i përbërë nga aktivet dhe pasivet e shoqërive që e përbëjnë atë, dhe shoqëritë shpërbëhen pa kaluar në likuiditet.

Transferimi

¹ CEE – Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

“Një shoqëri që shpërbëhet pa shkuar në likuidim, ia transferon të gjitha aktivët dhe pasivët e saj shoqërisë që mban të gjitha letrat me vlerë apo aksionet që përfaqësojnë kapitalin e saj”.

Ky është një transferim i një shoqërie te një tjetër (mbajtëse e totalit të aksioneve të letrave me vlerë që përfaqësojnë kapitalin e saj). Shoqëria që shpërbëhet pa kaluar në likuidim ia kalon gjithë aktivët dhe pasivët e saj shoqërisë që do ta përcaktojë si “shoqëria dominuese”.

Shënim:

Me gjithë këtë Direktiva lejon, me sa duket, vetëm themelimin e shoqërive me bashkim, përmes përfshirjes apo përmes themelimit të një shoqërie të re, meqë pagesa me para në dorë nuk e tejkalon 10% të vlerës nominale apo, në mungesë të vlerës nominale, të llogarive në vlerë nominale të atyre letrave me vlerë apo aksioneve të shoqërisë që rezultojnë nga bashkimi. Direktiva gjithashtu e ruan këtë rregull, sepse lejon që kjo vlerë të tejkalohet në rast se legjislacioni i një pjesëtari të Shtetit Anëtar e lejon pagesën e kësaj shume me para në dorë, në rastet e identifikuar më lart, mbi 10% të vlerës nominale apo, në mungesë të vlerës nominale, të llogarive në vlerë nominale të aksioneve apo atyre letrave me vlerë që përfaqësojnë kapitalin e ndërmarrjes që rezulton nga bashkimi ndërkufitar. Në këto raste, zbatohet gjithashtu kjo Direktivë.

Nëse deri tani kemi folur për rastet kur zbatohet Direktiva, do të trajtojmë rastet kur zbatimi i saj mund të përjashtohet.

Përjashtimi i parë i referohet mundësisë që kanë Shtetet Anëtare për të vendosur të mos e zbatojnë këtë Direktivë:

- Bashkimet ndërkufitare që përfshijnë një shoqëri bashkëvepruese edhe në rastet kur kjo e fundit hyn në përkufizimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar;

Gjithashtu, kjo Direktivë nuk do të zbatohet për bashkimet ndërkufitare që përfshijnë një shoqëri objekti i së cilës është investimi kolektiv i kapitalit të siguruar nga publiku, që funksionon sipas parimit të shpërndarjes së riskut dhe njësitë e së cilës, me kërkesë të pronarëve, riblihen apo shlyhen, direkt apo indirekt, nga pasuritë e asaj shoqërie. Masat e marra nga një shoqëri e tillë për të siguruar që vlerat e këmbimit të pasurive të njësive të saj nuk ndryshojnë shumë nga vlera neto e pasurive të saj do të konsiderohet si ekuivalente me këtë riblerje po shlyerje.

Cilat janë kushtet që është e nevojshme të verifikohen, me qëllim që bashkimi ndërkufitar të jetë i mundshëm?

Shoqëritë e përfshira duhet t’i përshtaten konceptit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”.

Të ekzistojë vullneti për integrimin e projektit të një bashkimi.

Shoqëritë mund të bashkohen sipas kushteve të legjislacionit kombëtar të Shteteve Anëtare të interesuara. Do të jetë legjislacioni kombëtar i çdo Shteti Anëtar, ku çdo shoqëri është e vendosur, që do të përcaktojë kushtet dhe formalitetet e procedimit (pra, lidhur me procesin e vendim-marrjes për bashkimin, mbrojtjen e kreditorëve të shoqërive që bashkohen, pronarëve të obligacioneve dhe pronarëve të letrave me vlerë apo aksioneve, si dhe të punonjësve – përveç atyre që lidhen me të drejtën e pjesëmarrjes, brenda kushteve të vetë Direktivës).

Shënim: Një Shtet Anëtar mund t’u japë mundësinë autoriteteve të tij kombëtare që ta kundërshtojnë një bashkim të caktuar të brendshëm për interesin publik dhe kjo do të zbatohet gjithashtu edhe për një bashkim ndërkufitar.

▪ *Procedura*

Projekti

Hapi i parë do të jetë hartimi nga ana e menaxhimit apo e organit administrativ **të secilës prej shoqërive që bashkohen, i një draft-projekti të përbashkët për bashkimin ndërkufitar.** Ky projekt i përbashkët do të përfshijë, të paktën:

- formën, emrin dhe zyrën e regjistruar të shoqërive që bashkohen dhe atyre të propozuara për shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar;
- raportin e zbatueshëm për këmbimin e letrave me vlerë apo aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë dhe shumën e çdo pagese me para në dorë;
- kushtet për ndarjen e letrave me vlerë apo aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar;
- pasojat e mundshme të bashkimit ndërkufitar mbi punësimin.
- datën nga kur mbajtja e këtyre letrave me vlerë apo aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë do t’u japë të drejtë zotëruesve të ndajnë fitimet dhe kushtet e veçanta që ndikojnë mbi këtë të drejtë;
- data nga e cila transaksionet e shoqërive që bashkohen do të trajtohen, për qëllime të kontabilitetit, si të ishin të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar;
- të drejtat që i akordohen shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar mbi anëtarët që gëzojnë të drejta të veçanta apo mbi zotëruesit e letrave me vlerë, përveç aksioneve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë, apo masat e propozuara në lidhje me to;
- çdo avantazh të veçantë që u jepet ekspertëve që shqyrtojnë draft-kushtet e bashkimit ndërkufitar apo anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese, mbikëqyrëse apo kontrolluese të shoqërive që bashkohen;

- statutet e shoqërisë që rezultojn nga bashkimi ndërkufitar;
- kur është e përshtatshme, informacion mbi procedurat sipas të cilave përcaktohen masat për përfshirjen e punonjësve në përkufizimin e të drejtave të tyre për pjesëmarrje në shoqërinë që rezultojn nga bashkimi ndërkufitar;
- informacion mbi vlerësimin e pasurive dhe detyrimeve që i transferohen shoqërisë që rezultojn nga bashkimi ndërkufitar;
- datat e llogarive të shoqërive që bashkohen që përdoren për të vendosur kushtet e bashkimit ndërkufitar.

Publikimi

Draft-termat e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar do të publikohen sipas ligjeve të çdo Shteti Anëtar, në përputhje me çdo shoqëri që bashkohet, të paktën një muaj para datës së takimit të përgjithshëm, çka mbetet për t'u vendosur.

Gjithashtu, duhet të publikohen në gazetën zyrtare të Shteteve Anëtare ku gjenden shoqëritë e ndryshme që bashkohen, të dhënat e mëposhtme:

- ⇒ lloji, emri dhe zyra e regjistruar e çdo shoqërie që bashkohet, regjistri dhe numri përkatës i hyrjes në atë regjistër;
- ⇒ marrëveshjet e bëra për ushtrimin e të drejtave të kreditorëve dhe të çdo anëtar të pakicave të shoqërive që bashkohen, si dhe adresën ku mund të merret falas informacion i plotë mbi këto marrëveshje.

Raporti

Gjithashtu, menaxhimi apo organi administrativ i secilës shoqëri që bashkohet do të hartojë një raport për anëtarët, ku të shpjegohen dhe justifikohen aspektet ligjore dhe ekonomike të bashkimeve ndërkufitare, si dhe të shpjegohen implikimet e bashkimit ndërkufitar për anëtarët, kreditorët dhe punonjësit. Këtë raport do ta përpunojnë ekspertë të pavarur që mund të jenë persona fizikë apo persona juridikë.

Një ose më shumë ekspertë të pavarur, të caktuar për këtë qëllim me kërkesën e përbashkët të shoqërive, përmes një autoriteti gjyqësor apo administrativ në Shtetin Anëtar të njërës prej shoqërive që do të bashkohen apo shoqërisë që rezultojn nga bashkimi ndërkufitar apo të miratuar nga një autoritet i tillë, do të shqyrtojnë draft-termat e përbashkëta dhe do të hartojnë një raport të vetëm me shkrim për të gjithë anëtarët.

Shoqëritë që bashkohen do t'u vënë në dispozicion ekspertëve informacionin që ata e konsiderojnë të nevojshëm për të përpunuar raportin.

Nuk do të kërkohet as shqyrtimi i draft-termave të përbashkëta të bashkimit ndërkuftar nga ekspertët e pavarur dhe as raporti i ndonjë eksperti, në rast se të gjithë anëtarët e secilës prej shoqërive të përfshira në bashkimin ndërkuftar kanë vendosur kështu.

Miratimi i projektit

Në rast se kjo mundësi nuk është përdorur, raporti do t'u vihet në dispozicion anëtarëve dhe përfaqësuesve të punonjësve ose, kur nuk ka përfaqësues të tillë, vetë punonjësve, **jo më pak se një muaj përpara datës së takimit të përgjithshëm që do të vendoste për miratimin e projektit të përbashkët.**

Ia vlen të përmendet se raporti do t'u vihet në dispozicion vetëm punonjësve nëse ndodh që nuk ka përfaqësues të tyre. Në lidhje me këtë mendojmë se është me rëndësi të mos harrojmë artikullimin e kësaj Direktive me Direktivat 2002/14/KE dhe 2009/38/KE, lidhur me marrjen në konsideratë të çdo shoqërie më vete dhe proceset e informacionit dhe konsultimit të parashikuara në kushtet e instrumenteve normative të referuara.

Në rast se ekziston një opinion nga përfaqësuesit e punonjësve dhe menaxhimi apo organi administrativ i ndonjërit prej shoqërive që do të bashkohen e ka marrë atë dhe opinionin është dhënë në përputhje me ligjin kombëtar përkatës, ky opinion duhet t'i bashkëngjitet raportit të përpunuar.

Takimi i përgjithshëm i secilës prej shoqërive që do të bashkohen do të vendosë për miratimin e draft-termave të përbashkëta të bashkimit ndërkuftar. Megjithatë, takimi mund të rezervojë të drejtën që ta bëjë zbatimin e bashkimit ndërkuftar të kushtëzuar nga ratifikimi i qartë i marrëveshjeve të vendosura lidhur me pjesëmarrjen e punonjësve në shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkuftar.

Ligjet e një Shteti Anëtar nuk është nevojë të kërkojnë miratimin e bashkimit nga mbledhja e përgjithshme e shoqërisë blerëse sa herë që, në cilësinë e organit social, kanë fuqinë ta detyrojnë shoqërinë, për çdo parregullsi të ndodhur që nuk i kundërvihet palëve të treta, nëse shoqëria provon se ato palë të treta ishin në dijeni të parregullsisë.

Shqyrtimi i ligjshmërisë

Lidhur me secilën prej shoqërive që bashkohen:

Në çdo Shtet Anëtar të interesuar autoriteti kompetent do të lëshojë pa vonesë për çdo shoqëri që bashkohet dhe që i nënshtrohet ligjit të brendshëm të atij Shteti, një certifikatë dëshmie për përfundimin si duhet të veprimeve dhe formaliteteve të para-bashkimit.

Megjithatë, më parë, çdo Shtet Anëtar do të përcaktojë gjykatën, noterin apo një autoritet tjetër kompetent që do të shqyrtojë ligjshmërinë e bashkimit ndërkuftar lidhur me atë pjesë të procedurës që ka të bëjë me çdo shoqëri që bashkohet dhe që i nënshtrohet ligjit të vet kombëtar. Ky autoritet do të garantojë në veçanti që shoqëritë e bashkuara i kanë miratuar

draft-termat e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar me të njëjtat kushte, dhe aty ku është e mundur, që marrëveshjet për pjesëmarrjen e punonjësve janë përcaktuar siç parashikohet nga kjo Direktivë.

Lidhur me përfundimin e bashkimit:

Sërish, çdo Shtet Anëtar do të përcaktojë gjykatën, noterin apo ndonjë autoritet tjetër kompetent që do të shqyrtojë ligjshmërinë e bashkimit ndërkufitar lidhur me atë pjesë të procedurës që ka të bëjë me përfundimin e bashkimit ndërkufitar, dhe aty ku është e mundur, krijimin e një shoqërie të re që vjen nga bashkimi ndërkufitar ku shoqëria e krijuar nga bashkimi ndërkufitar i nënshtrohet ligjit të saj kombëtar.

Çdo shoqëri që bashkohet do t'i paraqesë autoritetit kompetent të lartpërmendur certifikatën e përshkruar më lart brenda gjashtë muajve të lëshimit të saj, së bashku me draft-kushtet e përbashkëta të miratuara nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë në fjalë.

Vetëm atëherë bashkimi do të hyjë në fuqi. Ligji i Shtetit Anëtar, juridiksionit të të cilit i nënshtrohet shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, do të përcaktojë datën kur do të hyjë në fuqi bashkimi ndërkufitar.

Publiciteti

Çdo shoqëri e krijuar nga bashkimi do të paraqitet në regjistrin publik në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar juridiksionit të cilit i nënshtrohet shoqëria. Çdo ligj i Shteteve Anëtare juridiksionit të të cilit i nënshtroheshin shoqëritë e bashkuara do të përcaktojë, sipas territorit të atij Shteti, marrëveshjet për përfundimin e publikimit të bashkimit ndërkufitar në regjistrin publik ku secilës shoqëri i kërkohet të regjistrojë dokumentet.

Ndërsa shoqëria që krijohet nga bashkimi ndërkufitar do të regjistrohet në përputhje me ligjin e vendit të Shtetit Anëtar subjekt i të cilit është shoqëria.

Zyra për regjistrimin e shoqërive të krijuara nga bashkimi ndërkufitar duhet të njoftojë pa vonesë zyrën në të cilin i është kërkuar çdo shoqërie të regjistrojë dokumentet për hyrjen në fuqi të bashkimit ndërkufitar.

Fshirja e regjistrimit të vjetër, nëse ndodh, do të kryhet pas marrjes së njoftimit, por jo më parë.

▪ *Pasojat e bashkimit ndërkufitar*

Një bashkim ndërkufitar i kryer me Përfshirje apo me Transferim, dhe që nga data kur hyn në fuqi, do të ketë pasojat e mëposhtme:

- I. të gjithë aktivët dhe pasivët e shoqërisë që blihet do t'i transferohen shoqërisë blerëse;

II. anëtarët e shoqërisë që blihet do të bëhen anëtarë të shoqërisë blerëse;

III. shoqëria që bihet do të pushojë së ekzistuari.

Në rastet e bashkimit ndërkufitar të kryera përmes themelimit të një shoqërie të re, që nga data kur hyn në fuqi, do të ketë pasojat e mëposhtme:

A. të gjitha aktivët dhe pasivët e shoqërive që bashkohen do t'i transferohen shoqërisë së re;

B. anëtarët e shoqërive që bashkohen do të bëhen anëtarë të shoqërisë së re;

C. shoqëritë e bashkuara do të rreshtin së ekzistuari.

Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive të bashkuara që dalin nga kontratat e punësimit apo nga marrëdhëniet e punësimit dhe që ekzistojnë në datën kur hyn në fuqi bashkimi ndërkufitar, për shkak të hyrjes në fuqi të këtij bashkimi ndërkufitar, do t'i transferohen shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar në datën kur hyn në fuqi bashkimi ndërkufitar.

Vërehet njëfarë paralelizmi këtu me instrumentet normative të mëparshme të komunitetit që synojnë, ashtu si kjo Direktivë, të sigurojnë ruajtjen e të drejtave të punonjësve, pra, të gjendjes aktuale nga kontratat e tyre të punësimit dhe nga marrëdhëniet e punësimit, që do t'i transferohen shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

- Pjesëmarrja e punonjësve / e drejta e pjesëmarrjes së punonjësve -

E drejta e pjesëmarrjes është një formë e përfshirjes së punonjësve, e strukturuar në trilogjinë: Informacion, Këshillim dhe Pjesëmarrje, çka do të thotë e drejta për të zgjedhur dhe për t'u përfaqësuar në Organin Drejtues apo në Bordin Mbikëqyrës (në varësi të sistemit të zbatueshëm – dualist apo monist).

Mes sistemeve më të zakonshme (sistemet klasifikohen sipas numrit të përfaqësuesve në Bordin Menaxhues apo Mbikëqyrës të një shoqërie) theksohet sistemi i barazisë për shkak të rëndësisë së tij që mund të çojë në vendimeve vërtet të përbashkëta. Sistemi i barazisë do të thotë që ka një numër të barabartë përfaqësuesish, si nga pala e punonjësve ashtu edhe nga menaxhimi i shoqërisë apo bordi mbikëqyrës. Me këtë sistem përfaqësuesit e punonjësve në parim mund të vendosin në mënyrë të barabartë duke ndikuar kështu mbi vendimin që merret.

Në sisteme të tjera, veçanërisht në sistemin me një nivel, kjo mundësi është e largët pasi ka të bëjë kryesisht me marrjen e informacionit, me shkëmbimin e opinioneve, etj.

Përfaqësuesit e punëtorëve zgjidhen drejtpërdrejt nga punëtorët, ose caktohen në ndonjë mënyrë tjetër, dhe mund të jenë punonjës të shoqërisë përkatëse ose organizata sindikaliste që i përfaqësojnë këta punëtorë, apo individë që konsiderohet se përfaqësojnë në ndonjë mënyrë interesat e punëtorëve.

Shprehja “përfaqësues të punëtorëve” përfshin shprehjen e interesit kolektiv dhe jo atij individual dhe për këtë arsye ndryshon nga pjesëmarrja e drejtpërdrejtë sepse, siç u përmend,

thekson interesin kolektiv dhe jo atë individual; synimi është të arrihet investimi demokratik në vendimet e shoqërisë dhe zakonisht kjo pjesëmarrje rregullohet me ligj apo me marrëveshje kolektive, dhe nuk është një vendim thjesht i njëanshëm nga shoqëria në fjalë.

Objektivi i së drejtës së pjesëmarrjes lidhet me pretendimin se punëtorët kanë ide/informacion mbi vendimet/vendimet strategjike të shoqërisë. Dhe kjo ndryshon nga mekanizmi dhe konsultimi i informacionit për çështjet operative të ditës.

Përmbajtja dhe efekti ndryshojnë në varësi të sistemit të aplikuar. Nëse përfaqësuesit e punonjësve janë në pakicë, ajo çka ndodh në shumicën e rasteve, mundëson vetëm marrjen e informacionit, shkëmbimit të opinioneve, këndvështrimeve dhe argumenteve mbi strategjinë dhe drejtimin e shoqërisë, ndërsa nëse përfaqësuesit janë në numër të barabartë, mundësohet një vendimmarrje vërtet e përbashkët pasi ata kontrollojnë, vendosin veton dhe kanë ndikim të vërtetë mbi strategjinë e shoqërisë.

Ndryshimet lidhen, për shembull, me çështjet kulturore, si dhe me objektivin që duhet arritur. Pasi, nëse dëshirojmë një përfshirje të vërtetë të përfaqësuesve të punonjësve, duke u lejuar atyre jo vetëm qasje në informacion, por edhe fuqinë për të ndikuar në vendimet që do të merren, opsioni shkon për sistemin e barazisë, ndërsa nëse objektivi është shkëmbimi i informacionit, do të zgjedhim sistemin me një nivel apo ndonjë sistem tjetër.

Pjesëmarrja e punonjësve nuk parashikohet në gjithë legjislacionet kombëtare të Shteteve të ndryshme Anëtare. Vetëm disa e kanë dhe sistemet gjithashtu ndryshojnë. Nga ana tjetër, dhe siç është theksuar gjithnjë, ka edhe raste ku e drejta e pjesëmarrjes zbatohet/arrihet nëpërmjet marrëveshjeve kolektive, me vendim të partnerëve socialë.

Cilat janë sfidat kryesore?

E drejta e pjesëmarrjes ngre për aksionarët e tyre sfida të shumëllojshme, ndonëse të ndryshme, në varësi të përfaqësuesve të punonjësve dhe përfaqësuesve të shoqërisë.

Për punëtorin apo punëtorët që përfaqësojnë të tjerët pranë bordit menaxhues apo mbikëqyrës të shoqërisë së tyre, shumë shpejt lind një konflikt i brendshëm sepse çdo ditë ai/ajo është punonjës i shoqërisë, por duke qenë se është caktuar apo zgjedhur nga kolegët e vet apo nga strukturat e sindikatës që përfaqësohen në shoqëri (sipas rastit), është i pranishëm dhe merr pjesë në organin drejtues të shoqërisë, çka i jep qasje në informacionin e brendshëm apo edhe ndikim në procesin e vendimmarrjes.

Ky konflikt na çon në një tjetër që lidhet me doemos me të, si dhe me interesat e dyfishta dhe që duhet të mbizotërojë: interesi kolektiv dhe interesi individual. Kur i pari mbizotëron mbi të dytin, fakti është se eksperiencia ka treguar që shpesh janë interesat individuale që ia kalojnë interesit kolektiv, çka mund të çojë në konflikt ndërmjet anëtarëve.

Ç' duhet bërë me informacionin e marrë? Kjo është një ndër pyetjet që ngrihet më shpesh. Kjo ndodh pasi shpesh informacioni përçohet si konfidencial.

Përfaqësuesi i punëtorëve ndihet si i “burgosur” në pozitën e tij/saj pasi është caktuar apo zgjedhur në atë pozicion për të mbrojtur interesat e punëtorëve dhe për të garantuar që propozimet e tyre do të dëgjohen dhe do të merren në konsideratë, por nuk mund t’ua kalojë atë informacion anëtarëve. Si duhet të veprojë ai/ajo? Çfarë duhet bërë?

Ky është një shembull tjetër konflikti, krahas atyre të lartpërmendur, që mund të krijojë shqetësim.

Nga ana tjetër, lidhur me vetë shoqëritë, fakti i pasjes së përfaqësuesve në menaxhim mund të shkaktojë gjithashtu debate. Kjo mund të shkaktojë njëfarë paretie në shoqëri, si dhe mund të gjenerojë konflikt social.

Megjithatë, duke pasur parasysh ekzistencën e përfaqësuesve të punëtorëve në bordin menaxhues, përfaqësuesit e tjerë të shoqërisë mund t'i shtyjnë të tjerët për të arritur synimet e tyre. Pra, ata mund t'i "bllokojnë" përfaqësuesit e punëtorëve duke shfrytëzuar epërsinë e tyre në numër (nëse është ky rast), madje edhe t'u ushtrojnë trysni dhe t'i trembin përfaqësuesit e pranishëm aty.

Siç mund të shihet pjesëmarrja e përfaqësuesve në bordin mbikëqyrës mund të shkaktojë tek të dyja palët njëfarë skepticizmi. Kjo do të jetë padyshim një nga sfidat që has e drejta e pjesëmarrjes.

Direktiva 2005/56/KE dhe e drejta e pjesëmarrjes së punonjësve

Shoqëria e përftuar si rezultat i bashkimit ndërkufitar mund të regjistrohet vetëm nëse është arritur një marrëveshje mbi kushtet e pjesëmarrjes së punëtorëve ose nëse organet përkatëse të shoqërive të bashkuara zgjedhin pa negociata paraprake të bëhen drejtpërdrejtë subjekt i rregullave standarde të pjesëmarrjes, ose pasi arrihet fundi i periudhës së negociatave pa marrëveshje, apo nëse asnjëra nga shoqëritë e bashkuara nuk është rregulluar sipas rregullave të pjesëmarrjes para regjistrimit të shoqërisë rezultat i bashkimit ndërkufitar.

Statutet e shoqërisë rezultat i bashkimit ndërkufitar nuk mund të mbështesin në asnjë mënyrë atë çka është vendosur për përfshirjen e punonjësve.

Pra, për të ditur se cili ligj zbatohet, apo nëse shoqëria rezultat i bashkimit ndërkufitar e ka rregulluar apo jo pjesëmarrjen e punonjësve, do të duhet të shqyrtohen disa kërkesa, ashtu siç ndodh me të drejtën e pjesëmarrjes të parashikuar nga direktivat e SE.

Sipas termave të nenit 16 të kësaj Direktive, rregulli që zbatohet dëshmon se shoqëria rezultat i bashkimit ndërkufitar do t'i nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi pjesëmarrjen e punonjësve të Shtetit Anëtar të zyrës përkatëse të regjistruar.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet, nëse:

☐ Të paktën **njëra nga shoqëritë e bashkuara** gjashtë muaj para publikimit të draft-termave të bashkimit ndërkufitar ka një numër mesatar **punonjësish që kalon 500 dhe operon sipas një sistemi pjesëmarrjeje të punonjësve**, çka do të thotë kapaciteti për të ndikuar mbi veprimtaritë e shoqërisë i ushtruar nga organi përfaqësues i punonjësve dhe / ose përfaqësuesit e tyre nëpërmjet:

1. të drejtës për të zgjedhur apo caktuar disa nga anëtarët e organit mbikëqyrës apo administrativ të shoqërisë; ose

2. të drejtës për të rekomanduar dhe/ose për të kundërshtuar caktimin e disa apo të gjithë anëtarëve të organit mbikëqyrës apo administrativ të shoqërisë.

☒ Nëse ligji kombëtar i zbatuar në shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar:

parashikon të paktën të njëjtin nivel pjesëmarrjeje të punonjësve siç veprohej në shoqëritë përkatëse të bashkuara, matur duke iu referuar numrit të përfaqësuesve të punonjësve ndër anëtarëve e organit administrativ apo mbikëqyrës apo komisioneve të tyre apo të grupit të menaxhimit që mbulon njësitë e përfitimit të shoqërisë, subjekt i përfaqësimit të punonjësve, ose

parashikon për punonjësit e ndërmarrjeve të shoqërisë rezultat i bashkimit ndërkufitar që ndodhen në Shtete të tjera Anëtare të njëjtën të drejtë për të ushtruar të drejtat e përfaqësimit ashtu siç i gëzojnë punonjësit e punësuar në Shtetin Anëtar ku shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar ka zyrën e saj të regjistruar.

Kështu provohet, të paktën në dukje, të mbrohet e drejta e përfaqësimit dhe humbja e saj eventuale.

Në raste përjashtuese do të zbatohen rregullat e Shteteve Anëtare dhe ndonëse me përshtatjet e nevojshme, edhe disa nga rregullat e parashikuara në Rregulloren SE dhe në Direktivën 2001/86/KE që rregullojnë përfshirjen e punonjësve në SE.

- Themelimi dhe përbërja e Organit Special të Negocimit -

Në këtë kuptim duhet themeluar një grup i veçantë negociimi, i emëruar nga OSN, që do të mundësojë negociimin e së drejtës së përfaqësimit ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve.

Kur krijohet projekti i bashkimit ndërkufitar, organet menaxhuese apo administrative të shoqërive që bashkohen duhet të japin informacion mbi identitetin e shoqërive që bashkohen dhe numrin e punonjësve, për të filluar negociatat me përfaqësuesit e punonjësve të këtyre shoqatave për përfshirjen e punonjësve dhe të drejtën e pjesëmarrjes brenda shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

Për këtë dhe në rast se organet përkatëse të shoqërive të bashkuara kanë zgjedhur pa negociata paraprake që të jenë subjekt i drejtpërdrejtë i rregullave standarde për pjesëmarrje, do të krijohet një Organ Special Negociatash, më pas i identifikuar si OSN.

OSN, që përbën një grup të veçantë negociatash të punonjësve të shoqërive të bashkuara do të ngrihet sipas një rregulli: **“Çdo shtet i përfshirë duhet të ketë një përfaqësues”**, për të siguruar që ata anëtarë janë zgjedhur apo përcaktuar në proporcion me numrin e punonjësve të punësuar në çdo Shtet Anëtar nga shoqëritë e bashkuara, duke i atribuar çdo Shtet Anëtar një vend për çdo fraksion të 10% apo një fraksion të kësaj vlere të numrit të punonjësve të punësuar nga shoqëritë e bashkuara në gjithë Shtetet Anëtare, konsideruar si një e tërë.

Duhet garantuar që ka aq anëtarë shtesë për çdo Shtet Anëtar, sa duhen për të siguruar që OSN të përfshijë të paktën një anëtar që përfaqëson çdo shoqëri të bashkuar dhe se ka punonjës në atë Shtet Anëtar, duke qenë se numri i këtyre anëtarëve shtesë nuk e kalon 20% të totalit të anëtarëve të caktuar dhe se përbërja e OSN-së nuk ka, si rrjedhojë, një përfaqësim të dyfishtë të punonjësve.

Në rastin konkret Direktiva niset nga ky parim duke vendosur disa kufizime. Megjithatë, për një kuptim më të lehtë, e fillojmë këtë përjasje me një rregull dhe me një shembull konkret. Për të kuptuar më mirë çfarë nënkuptonte Direktiva në këtë rast, do të paraqesim një shembull disi të komplikuar:

Vendi	Shoqëria X	Shoqëria Y	Shoqëria Z	Totali për vend
Portugali	50	100	200	350
Spanjë	60	140	30	230
Danimarkë	35	15	100	200
Totali	145	255	330	780

Më pas përsërisim hapat e ndjekur në shembullin e mëparshëm dhe përcaktojmë numrin e përfaqësuesve për shtet, bazuar në parimin e një vendi sipas çdo fraksioni të punonjësve të punësuar në atë Shtet Anëtar, që i korrespondon 10% apo një fraksioni të asaj shume.

Shteti	Shoqëria X	Shoqëria Y	Shoqëria Z	Totali për shtet	%	Nr. i vendeve në OSN
Portugali	50	100	200	350	44,8	5
Spanjë	60	140	30	230	29,4	3
Danimarkë	35	15	100	200	25,6	3

Në rast të një shkrirjeje shtohet kërkesa që të gjitha shoqëritë e bashkuara të jenë të përfaqësuara. Në këtë kuptim Direktiva përcakton burimin e anëtarëve shtesë.

Në këtë mënyrë dhe siç është theksuar, çdo shoqëri të bashkuar duhet t'i atribuohet një vend, në rast se ajo shoqëri nuk përfaqësohet në fund të operacionit të parë. Megjithatë, Direktiva jep kufizime për këtë rregull, çka do të thotë se numri i vendeve shtesë nuk mund të kalojë 20%.

Në rastin tonë konkret nuk do të ishte problem, pasi në të gjitha vendet, gjithë shoqëritë e bashkuara janë të përfaqësuara.

Tani do ta ndryshojmë paksa shembullin:

Shteti	Shoqëria X	Shoqëria Y	Shoqëria Z	Totali për shtet	%	Nr. i vendeve në OSN	Nr. i anëtarëve shtesë
Portugali	50	100	200	359	49,6	5	-
Spanjë	60	140	30	230	32,6	4	-
Danimarkë	15	10	100	125	17,8	3	1
Totali	125	250	330	705	100	11	1

Megjithatë, numri i anëtarëve shtesë nuk mund të kalojë 20% të anëtarëve të zakonshëm, ndaj në këtë rast, numri i zakonshëm është 11, pra, që të gjitha shoqëritë që përfaqësohen është e nevojshme që t'i atribuojnë një vend shtesë Danimarkës, dhe ky anëtar shtesë, në këtë rast, nuk e kalon vlerën. Kështu nuk do të përbëjë problem.

Le të ngremë tani mundësinë që kjo vlerë ta kalojë 20%, vendet do të ndahen sipas një rendi në zbritje të numrit të punonjësve. Tani po paraqesim një shembull tjetër:

Shteti	Shoqëria X	Shoqëria Y	Shoqëria Z	Totali për shtet	%	Nr. i vendeve në OSN	Nr. i anëtarëve shtesë
Portugali	50	100	200	350	57	6	-
Spanjë	60	140	30	230	37,5	4	-
Danimarkë	2	11	1	14	2,2	1	2
Greqi	5	2	12	19	3,3	1	2
Total	117	253	243	613	100	12	4

Në këtë shembull, katër anëtarët e nevojshëm shtesë për të mundësuar që gjithë shoqëritë e bashkuara të jenë të pranishme në OSN e tejkalojnë dukshëm kriterin e 20%, duke arritur një vlerë prej 33%, sepse do të jenë medoemos katër përfaqësues më shumë.

Për këtë arsye dhe në këtë situatë, Portugalia dhe Spanja nuk do të kenë nevojë për anëtarë shtesë, pasi të jenë përfaqësuar të gjitha shoqëritë.

Pas kësaj duhet të analizohet se cili është numri maksimal i vendeve të pranuar shtesë. Në këtë shembull numri maksimal i pranueshëm është dy.

Direktiva ia atribuon këto vende shoqërive më të mëdha që ende nuk përfaqësohen dhe në Shtetet Anëtare të ndryshme. Kështu, sipas këtij shembulli, vende shtesë do t'i jepen shoqërisë me numrin më të madh të punonjësve, por ende të papërfaqësuar, dy vendet do t'i jepen Shoqërisë Z në Greqi dhe një tjetër vend Shoqërisë Y në Danimarkë.

- Mënyra e zgjedhjes -

Shtetet Anëtare do të vendosin mënyrën e zgjedhjes apo të emërimit të anëtarëve të OSN-së që do të zgjidhen apo do të emërohen në territorin e tyre, si dhe do të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që, kurdo që është e mundur, të ketë mes anëtarëve të grupit të paktën një përfaqësues nga çdo shoqëri e bashkuar që ka punonjës në territorin e Shtetit Anëtar.

Ligjet e Shteteve Anëtare mund të parashikojnë që mes anëtarëve të grupit të përfshihen në mënyrë të barabartë përfaqësues të sindikatave, pavarësisht nëse janë apo jo të punësuar në një nga shoqëritë e bashkuara apo në një ndërmarrje që ka lidhje me to.

Shtetet Anëtare do të sigurojnë që punonjësit e shoqërive apo ndërmarrjeve ku nuk ka përfaqësues të punonjësve, për arsye të panjohura për vullnetin e tyre, të kenë të drejtë të zgjedhin apo të emërojnë anëtarë në OSN.

OSN vendos se si do të jetë përfshirja e punonjësve brenda shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, çka bëhet me një marrëveshje me shkrim ndërmjet këtij organi dhe organeve kompetente të shoqërive që bashkohen.

- Shqyrtime -

OSN vendos *me shumicë, që përfaqëson shumicën e punonjësve, se çdo anëtar ka të drejtën e një vote*. Këtu ka një risi, gjithashtu, për sa i përket legjislacionit të mëparshëm. Në këtë rast, krahas numërimit të votave, është gjithashtu e nevojshme të verifikohet kuptimi i votës së përfaqësuesve, çka mund ta kufizojë, në njëfarë mënyre, lirinë e votës.

Përjashtime: OSN ka të drejtë të vendosë, me shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të tij, që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e punonjësve, përfshirë votat e anëtarëve që përfaqësojnë punonjës në të paktën dy Shtete të ndryshme Anëtare, për të mos i hapur negociatat apo për t'i mbyllur negociatat e hapura më parë.

Nëse rezultati i negociatave çon në një kufizim të numrit të përfaqësuesve të punonjësve në organin administrative të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, do të kërkohet një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve të OSN-në, që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e punonjësve, përfshirë votat e punonjësve të punësuar në dy Shtete Anëtare minimumi, nëse pjesëmarrja mbulon të paktën 33% të numrit total të punonjësve të shoqërive që bashkohen.

Ka një kufizim të të drejtave të pjesëmarrjes nëse numri i anëtarëve të organeve të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, në termat e konceptit të “pjesëmarrjes”, e kuptuar si e drejta për të zgjedhur ose për emëruar disa nga anëtarët e organit mbikëqyrës apo administrativ, apo e drejta për të emëruar dhe/ose për të refuzuar emërimin e disa ose të gjithë anëtarëve të organit mbikëqyrës apo administrativ të shoqërisë, është inferior krahasuar me numrin më të lartë në shoqëritë e bashkuara.

Nëse në vijim të negociatave paraprake, rregullat standarde për pjesëmarrje aplikohen pavarësisht këtyre rregullave, Shtetet Anëtare mund të vendosin ta kufizojnë numrin e përfaqësuesve të punonjësve në organin administrativ të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar. Megjithatë, nëse në njërin nga shoqëritë e bashkuara përfaqësuesit e punonjësve përbënin të paktën një të tretën e bordit administrativ apo mbikëqyrës, kufizimi mund të mos rezultojë me një numër më të ulët se një e treta e përfaqësuesve të punonjësve në organin administrativ.

- Funksionimi -

OSN mund të kërkojë mbështetjen e ekspertëve të zgjedhur prej tij, për shembull, përfaqësues të organizatave të duhura të sindikatave në nivel komuniteti. Këta ekspertë mund të jenë të pranishëm në mbledhjet për negociata, duke luajtur një rol konsultativ, sipas kërkesës së OSN-së, nëse është e nevojshme për të promovuar koherencën dhe përputhshmërinë në nivel komuniteti. OSN mund të vendosë t'i informojë përfaqësuesit e organizatave të duhura të jashtme, përfshirë organizatat e sindikatave për fillimin e negociatave.

Shpenzimet për funksionimin e OSN-së dhe përgjithësisht të negociatave, përballohen nga shoqëritë e bashkuara, në mënyrë që OSN të mund ta përmbushë plotësisht misionin e tij (Shtetet Anëtare mund t'i kufizojnë financimit vetëm me mbulimin e shpenzimeve të një eksperti).

- Konfidencialiteti -

Shtetet Anëtare do të vendosin që anëtarët e OSN-në, organi përfaqësues, si dhe ekspertët që i asistojnë, të mos jenë të autorizuar që t'u zbulojnë palëve të treta informacionin që u është transmetuar si konfidencial.

Ky detyrim zbatohet pavarësisht vendit ku janë këta persona, si dhe pas përfundimit të mandateve përkatëse.

Çdo Shtet Anëtar do të vendosë që në raste specifike dhe në përputhje me kushtet dhe kufizimet e vendosura nga ligji kombëtar, organi mbikëqyrës apo administrativ të mos komunikojë informacionin, që për nga natyra e tij dhe sipas kritereve objektive, mund të dyshohet se pengon seriozisht operimin e shoqërisë.

- Marrëveshja -

Negociatat do të fillojnë sapo të themelohet OSN-ja dhe do të vazhdojnë gjatë gjashtë muajve në vijim. Kjo periudhë mund të zgjatet, nëse palët bien dakord për këtë, përtej gjashtë muajve deri në një vit gjithsej, duke u llogaritur që nga krijimi i OSN-në.

Përjashtim: organet përkatëse të shoqërive që bashkohen kanë të drejtë të zgjedhin pa asnjë negociatë paraprake që t'u nënshtrohen drejtpërdrejt rregullave standarde për pjesëmarrje referuar në nenin 16, paragrafi 3 (h), siç përcaktohet nga legjislacioni i Shtetit Anëtar ku shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar ka zyrën e saj të regjistruar, si dhe t'u përmbahen atyre rregullave që nga data e regjistrimit.

Organet kompetente të shoqërive që bashkohen dhe OSN duhet të negociojnë me një frymë bashkëpunimi për të arritur një marrëveshje lidhur me përfshirjen e punonjësve në shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

Marrëveshja e arritur përcakton shtrirjen e zbatimit të saj.

Nëse gjatë procesit të negociatave palët vendosin të krijojnë një marrëveshje pjesëmarrjeje, elementet themelore e saj përfshijnë, nëse është rasti, numrin e anëtarëve të organit administrativ apo mbikëqyrës të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar që punonjësit do të kenë të drejtë të zgjedhin, të përcaktojnë, të rekomandojnë apo të refuzojnë, si dhe procedurat sipas të cilave anëtarët mund të zgjidhen, të përcaktohen apo të refuzohen nga punonjësit, si dhe të drejtat e tyre.

Marrëveshja do të përfshijë edhe datën në të cilën ajo hyn në fuqi, si dhe kohëzgjatjen, rastet kur marrëveshja mund të rinegociohet dhe procesin e rinegocimit.

Si e tillë, OSN mund:

Të vendosë të mos fillojë ose t'u japë fund negociatave tashmë të hapura (për një shumicë prej dy të tretat e anëtarëve që përfaqësojnë dy të tretat e punonjësve dhe të paktën dy Shtete Anëtare të ndryshme). Në këtë rast rregullat që do të zbatohen për pjesëmarrjen e punonjësve do të jenë ato të Shtetit Anëtar ku do të jetë e vendosur zyra e regjistruar e shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar;

Nëse OSN vendos të mos hapë i negociatat apo t'u japë fund negociatave që janë tashmë të hapura dhe nuk u drejtohet dispozitave të Shtetit Anëtar të zyrës së regjistruar të shoqërisë që do të themelohet, do të zbatohen dispozitat standarde të Shtetit Anëtar me zyrë të regjistruar të shoqërisë që do të themelohet nëse të paktën një e treta e punonjësve ka pasur më parë të drejtë pjesëmarrjeje.

Të bjerë dakord për përfshirjen e punonjësve dhe të drejtat e tyre për pjesëmarrje;

Të bjerë dakord për një reduktim të të drejtave - negociatat mund të çojnë në një reduktim sasior të të drejtave të pjesëmarrjes (votat e dy të tretave të anëtarëve të OSN-së që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e punonjësve, përfshirë votat e punonjësve të punësuar në dy Shtete Anëtare minimumi, nëse pjesëmarrja mbulon të paktën 33% të numrit total të punonjësve të shoqërive të krijuara nga bashkimi).

Të bjerë dakord për zbatimin e dispozitave standarde që kufizojnë numrin e përfaqësuesve të punonjësve në organin mbikëqyrës apo administrativ. Megjithatë, nëse në njërën nga shoqëritë e krijuara nga bashkimi, përfaqësuesit e punonjësve përbëjnë një të tretën e organit mbikëqyrës apo administrativ, kufizimi nuk mund të jetë më pak se një e treta;

Të mos arrijë marrëveshje apo të mos e përfundojë periudhën e parashikuar për negociata dhe për arritjen e marrëveshjes dhe në këto raste do të zbatohen dispozitat standarde të Shtetit Anëtar me zyrë të regjistruar të shoqërisë që do të krijohet;

Gjithashtu, nëse përpara procesit të regjistrimit janë aplikuar një ose më shumë forma pjesëmarrjeje në një apo më shumë shoqëri, përfshirë më pak se 33% të numrit total të punonjësve të grupit të shoqërive të bashkuara, OSN-ja mund të vendosë të zbatojë dispozitat standarde. Në këtë rast, OSN-ja do të vendosë se cila formë do të miratohet në shoqërinë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

Dispozitat standarde do të zbatohen përsëri nëse para regjistrimit, një ose më shumë forma të pjesëmarrjes janë zbatuar në një apo më shumë shoqëri, duke përfshirë të paktën 33% të numrit të përgjithshëm të punonjësve të grupit të shoqërive që bashkohen;

Gjithashtu, palët mund të bien dakord për zbatimin e rregullave standarde; kjo mund të ndodhë edhe nëse organet kompetente vendosin kështu nëse një marrëveshje nuk arrihet dhe organet kompetente e pranojnë zbatimin e tyre.

Shtetet Anëtare kanë të drejtë të zgjedhin që të mos transpozojnë në legjislacionin e tyre kombëtar dispozitat standarde të pjesëmarrjes të parashikuara nga Direktiva 2001/86 /KE. Në këtë rast, nëse nuk është e mundur të arrihet një marrëveshje mbi të drejtën e pjesëmarrjes

dhe disa nga shoqëritë e kanë pasur këtë të drejtë më parë, shoqëria që rezulton nga bashkimi ndërkufitar nuk mund të regjistrohet në atë Shtet Anëtar, përveçse kur ka një marrëveshje apo asnjë nga shoqëritë e bashkuara nuk ka pasur pjesëmarrje më parë.

- Mbrojtja e Punonjësve -

Anëtarët e OSN-së, përfaqësuesit e punonjësve që marrin pjesë në organin mbikëqyrës apo administrativ të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar dhe që janë të punësuar prej saj, apo prej njërës nga shoqëritë që bashkohen, kanë mbrojtje dhe garanci identike si ato që u sigurohen përfaqësuesve të punonjësve nga ligji kombëtar i vendit që i punëson. Kjo zbatohet, veçanërisht, në takimet e OSN-në apo në çdo takim tjetër të organit mbikëqyrës apo administrativ, si dhe në lidhje me pagesën e shpërblimit të anëtarëve për periudhat e mungesës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

- Shqyrtimi i ligjshmërisë -

Shteti Anëtar që ka në territorin e tij menaxhimin e ndërmarrjeve të një shoqërie që krijohet nga bashkimi ndërkufitar, si dhe shoqëri që bashkohen dhe punonjësit përkatës, duhet të sigurojë që menaxhimi i shoqërisë dhe i punonjësve të saj të bëhet në përputhje me atë që përcaktohet nga ligji i Komunitetit. Gjithashtu, Shteti Anëtar do të marrë masat e duhura kundër mosrespektimit, duke vënë në dispozicion procese administrative dhe gjyqësore që lejojnë zbatimin e detyrimeve që rezultojnë prej kësaj.

Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të garantuar që struktura e përfaqësimit të punonjësve të shoqërive që bashkohen të reshti së ekzistuari, ndërsa njësitë ligjore dhe autonome të ruhen pas regjistrimit të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar.

- Dispozitat standarde -

Punonjësit e shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, degët dhe ndërmarrjet kanë të drejtën të zgjedhin, të përcaktojnë, të rekomandojnë apo të kundërshtojnë përcaktimin e një numri anëtarësh të organit mbikëqyrës apo administrativ të shoqërisë që rezulton nga bashkimi ndërkufitar, të barabartë me numrin më të lartë në fuqi në njërën prej shoqërive të bashkuara para regjistrimit.

Nëse ndonjëra nga shoqëritë ka pasur rregulla pjesëmarrjeje përpara regjistrimit, nuk është e detyruar që të vendosë dispozita për sa i përket pjesëmarrjes së punonjësve.